

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Artan Sejrani, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Teuta Spahiu procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.B. nga ..., për shkak të dy veprave penale mashtrim me subvencione nga neni 336 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 të KP-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP/I.nr.283/2016 të datës 19.05.2017 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e Prokurorit të shtetit Ervehe Gashi, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av. F.L. nga ... me datë 02.08.2017 publikisht mori dhe shpalli këtë:

AKT GJYKIM

I akuzuari:

2.A.B., nga i ati J..., dhe e ëma F..., e lindur ..., i lindur më datën ..., në ..., ku edhe tani jeton në rrugën “...” pn., ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, me profesion suvator, beqar, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër ... të lëshuar nga MPB-ja në Prishtinë.

ËSHTË FAJTORË

2.1. Se i pandehuri A.B. i paraqet organit kompetent të dhëna të pasakta lidhur me aplikimin për marrjen e një subvencioni e që është kusht për marrjen e subvencionit në atë mënyrë që në ... me dt. 16.04.2014 me aplikacionin nr. 018 për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese aplikon në Agjencinë për zhvillimin e bujqësisë së Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural duke ia bashkangjitur dokumentin “...” me nr. Identifikues ... dt. 28.04.2014 në emër të H.B. dhe kontratën për dhënjen e tokës bujqësore me qira në mes të tij dhe M.B. gjoja se merret me vreshtari dhe fiton nga kjo agjenci subvencionin prej dymijë e tetëqind e pesëdhjetë euro (2,850,00 €), e në realiteti kjo vreshtë ishte inaktive qysh dy vjet para paraqitjes së aplikacionit.

Këso dore ka kryer veprën penale mashtrim me subvencione nga neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së.

2.2. I pandehuri A.B. i paraqet organit kompetent të dhëna të pasakta lidhur me aplikimin për marrjen e një subvencioni e që është kusht për marrjen e subvencionit në atë mënyrë që në Suharekë me dt. 07.05.2015 me aplikacionin nr. ... për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese aplikon në Agjencinë për zhvillimin e bujqësisë të Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural duke ia bashkangjitur dokumentin “...” me nr. Identifikues ... dt. 29.05.2015 në emër të I.B. dhe ... dt. 30.04.2015 në emër të L.B., gjoja se merret me vreshtari dhe fiton nga kjo agjenci subvencionin prej një mijë e dyqind e nëntëdhjetë euro (1,290.00 €).

Këso dore ka kryer veprën penale mashtrim me subvencione neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 8, 9, 10, 22, 41, 43, 46, 73, neni 336 parag.1 - 2 të KP-së dhe neni 365 të KPP-së, të akuzuarin:

GJYKON

- për veprën penale si nën 2.1 të dispozitivit ia shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 700 (shtatqindë) euro.
- për veprën penale si nën 2.2 të dispozitivit ia shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 700 (shtatqindë) euro.
- Duke aplikuar dispozitat e nenit 80 parag. 1 e 2 nënparag. 2.4 të KP-së, të akuzuarit i **shqiptohet dënimi unik me gjobë në shumë prej 1400 (njëmijekatërqind) euro**, të cilën gjobë i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund të paguajë dënimin me gjobë, i njëjti zëvendësohet me dënim me burg, ashtu që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet një ditë burg.

Pala e dëmtuar Agjencia për zhvillimin e bujqësisë në Prishtinë, Rr. “Luan Haradinaj” – ish Ndërtesa e Bankës së Lubjanës në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 100 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/I.nr.283/2016 të datës 19.05.2017 kundër të akuzuarit A.B. nga ..., për shkak të dy veprave penale mashtrim me subvencione nga neni 336 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 të KP-së.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se i pandehuri A.B. i paraqet organit kompetent të dhëna të pasakta lidhur me aplikimin për marrjen e një subvencionit e që është kusht për marrjen e subvencionit në atë mënyrë që në ... me dt. 16.04.2014 me aplikacionin nr. ... për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese aplikon në Agjencinë për zhvillimin e bujqësisë së Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural duke ia bashkangjitur dokumentin “...” me nr. Identifikues ... dt. 28.04.2014 në emër të H.B. dhe kontratën për dhënjën e tokës bujqësore me qira në mes të tij dhe M.B. gjoja se merret me vreshtari dhe fiton nga kjo agjenci subvencionin prej dymijë e tetëqind e pesëdhjetë euro (2,850,00 €), e në realiteti kjo vreshtë ishte inaktive qysh dy vjet para parashtrimit të aplikacionit.

I pandehuri A.B. i paraqet organit kompetent të dhëna të pasakta lidhur me aplikimin për marrjen e një subvencionit e që është kusht për marrjen e subvencionit në atë mënyrë që në ... me dt. 07.05.2015 me aplikacionin nr. ... për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese aplikon në Agjencinë për zhvillimin e bujqësisë së Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural duke ia bashkangjitur dokumentin “...” me nr. Identifikues ... dt. 29.05.2015 në emër të I.B dhe ... dt. 30.04.2015 në emër të L.B., gjoja se merret me vreshtari dhe fiton nga kjo agjenci subvencionin prej njëmijë e dyqind e nëntëdhjetë euro (1,290.00 €).

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimit i fajsisë nga ana e të akuzuarit i cili në shqyrtimin fillestar pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata, konform nenit 257 të KPP, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimit i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhë në përfundim, se pranimit i fajsisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale mashtrim me subvencione nga neni 336 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 të KP-së, dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimin, duke mos gjetur rrethana renduese, e si rrethanë lehtësuese është marrë pranimit i fajsisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, gjer më tani i pa gjykuar, çka nënkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive, është njeri familjar, është mbajtës i familjes, moshën e tij, arsimimin e tij, andaj gjykata i shqiptoi dënimin unik me gjobë në shumë prej 1400 (njëmijëekatërqind) euro, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimin që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest të rregullt civil juridiko civil, gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 par.1 e 2 të KPP.

Vendimi mbi shpenzimet dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 453 par. 1 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.77/17 të datës 02.08.2017.

Procesmbajtësja
Teuta Spahiu

Gjyqtari,
Artan Sejrani

UDHËZIM JURIDIKË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.